



Albanian-American  
Development Foundation

LEAD ALBANIA  
PROGRAM FOR LEADERSHIP EXPERIENCE AND DEVELOPMENT

THIRRJE PËR APLIKIME

# LEAD Albania 2024



## LEAD Albania

Program për Përvojë dhe Zhvillim në Lidership

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim hap thirrjen për aplikime për Programin “LEAD Albania 2023”, i konceptuar sipas Programit të Shtëpisë së Bardhë për Lidershipin (White House Fellows Program) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qëllimi i Programit në Shqipëri është që t’u sigurojë profesionistëve të rinj e të talentuar shqiptarë një përvojë njëvjeçare të drejtpërdrejtë në procesin e qeverisjes së Shqipërisë, shoqëruar nga një ndjesi e përfshirjes personale në lidershipin e shoqërisë sonë, duke e vendosur përfituesin pranë një pozicioni qeveritar shumë të lartë. Individëve të përzgjedhur do t’u ofrohet mundësia për të punuar në kabinetet e titullarëve të institucioneve të qeverisjes qendrore në Kryeministri dhe Ministri,

në Institucionin e Presidentit, në Bashkinë Tiranë, dhe në kabinetet e titullarëve të institucioneve qeverisëse të Sistemit të Drejtësisë: ILD, KLP, KLGJ, SPAK dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo përvojë pasurohet me një komponent edukimi, i cili do të shoqërojë eksperiencën e punës së përfituesve nëpërmjet seminareve dhe takimeve me temë si: integrimi evropian, politikat publike, vendimmarrja, politika të jashtme, politika të sigurisë, zhvillimi i kompetencave sociale dhe aftësive të lidershipit. Programi do të mbulojë për secilin individ të përzgjedhur shpenzimet që lidhen me pagën dhe përfitimet përkatëse, sipas kategorisë së pagave në institucionin ku do të vendosen.



## Kushtet për të aplikuar

Për të aplikuar në programin “LEAD Albania”, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Programi nuk ka kufizime moshe por është krijuar për t'u dhënë pjesëmarrësve përvojën e qeverisjes në fazat e para të karrierës së tyre.
- Personat të cilët punojnë aktualisht në Kryeministri dhe Ministri, në Institucionin e Presidentit, në Bashkinë Tiranë në Institucionet qeverisëse të Sistemit të Drejtësisë dhe Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm nuk mund të aplikojnë.
- Aplikantët duhet të jenë nënshettas shqiptarë (pranohet nënshettësia e dyfishtë).
- Aplikantët duhet të kenë përfunduar studimet në arsimin e lartë. Përfundimi i studimeve pasuniversitare mund të jetë avantazh i rëndësishëm.
- Aplikantët duhet të kenë të paktën pesë vite përvojë pune. Në rast përfundimi të studimeve të doktoraturës, minimumi i preferuar është tre vjet.



## Profili i kandidatëve

**Programi “LEAD Albania” dhe Komisioni Përzgjedhës do të kenë parasysh kriteret e mëposhtme në përzgjedhje:**

- Arritje profesionale të rëndësishme në karrierë
- Dëshmi të aftësive për lidhshmëri dhe potencial për rritje të mëtejshme
- Interes i provuar për sferën publike dhe/ose shoqërinë civile
- Aftësi për të pasur sukses në nivelet më të larta qeveritare dhe aftësi për të punuar efektivisht në ekip.

**Cilësi të tjera të rëndësishme përfshijnë:**

- Aftësi shumë të mira në të shkruar
- Zotërim i shkëlqyer i gjuhës angleze
- Qëndrim pozitiv
- Aftësi të mira menaxhuese
- Aftësi shumë të mira ndërpersonale
- Nivel të mirë ekspertize në fushën e propozuar si fokus në kuadër të Programit

## Procedura e aplikimit

Aplikimi kryhet vetëm online. Informacione të mëtejshme dhe udhëzimet përkatëse gjenden në faqen e internetit [www.aadf.org/lead](http://www.aadf.org/lead). Afati i fundit i dorëzimit të aplikimeve është **data 17 Mars 2023, ora 17:00**. Nuk do të konsiderohen të vlefshme aplikimet e paraqitura dorazi apo me email.